

SPECIFIKIME TEKNIKE

TE IMPIANTEVE MEKANIKE

“NDËRTIM KOPËSHT DHE ÇERDHE E INTEGRUAR NR. 50 ”

SISTEMI I MBROJTJES NDAJ ZJARRIT

Fikesat portabel:

Fikse zjarri portabel me pluhur te thate, 6kg, tipi 34A 233BC per montim ne mur.



SISTEMI I HIDROSANITAR

Tubacionet nentokesore te shkarkimit:

Tubacion i brinjezuar tip PE-HD SN8 i pershtatshem per shkarkime te ujrave te perdorura dhe per montim nentoke.



Tubacionet e shkarkimeve te brendshme:

Tubacion plastik PP (Polypropilene) me 3 shtresa dhe bashkim me gomine, me veti shuarese te zhurmave, prodhuar sipas normes EN 1451, i pajisur me gomine per rakordimet me pjeset Prodhuesi, norma dhe karakteristikat te stampuara ne trup nga fabrika).



Tubacionet e furnizimit me uje:

Per realizimin e rrjtit te tubacioneve te ujit te ngrohje dhe te ftohte nga matesi deri te secili rubinet, do te perdoret tubacion prej materiali PPR, prodhuar sipas normes EN 15874, i certifikuar per uje sanitar te pijshem, presion 10 bar.



SISTEMI I FRESKIMIT

Pompa e nxehtesise:

Chiller me cikel reversibel (Heat Pump) me ftohje me ajer, me eficence te larte, i pershtateshem per kondicionim dhe ngrohje.

Kapaciteti ne ftohje 59 kW ne temperature 35°C, kapaciteti ne ngrohje 59 kW - ne temperature 7°C.

Versioni full-optional (kit kontrolli dhe komandimi ne distance, kit hidraulik dhe elektropompe, izolim akustik i kompresoreve, monitor faze, antivibrante).



Fan Coil:

Fan Coil per vendosje vertikale ne dysheme, me 2 tuba, bateri Al-Cu me tre radhe, ventilator centrifugal dhe motor me tre shpejtesi, filter te pastrueshem, valvol 3 rrugeshe e paramontuar ne fabrike.

Fuqia termike ne ftohje: referuar karakteristikave - uje 7/12°C, ajer 27°C d.b./19°C w.b, konsideruar ne shpejtesine mesatare

Fuqia termike ne ngrohje: referuar karakteristikave - uje 45/40°C, ajer 20°C d.b. konsideruar ne shpejtesine mesatare.

Ventilatori: presion statik i mesem

Presioni i zhurmes ne shpejtesine mesatare: 35 dBA.



SISTEMI I NGROHJES NGA DYSHEMEJA

Paneli izolues:

Panel polistireni i papershkueshem nga uji (sipas EN 13163), me strukture qelizash te mbyllura, e cila ka rezistence te larte mekanike. Ky panel eshte i kombinuar me nje film plastik të posaçem per ta mbrojtur ate nga lageshtia dhe per te permiresuar rezistencen nga deformimi te siperfaqes nga shkelja. Pershkueshmeri termike $0,035 \text{ W} / (\text{m} \cdot \text{K})$, izolues 20 mm trashesi, trashesi totale 48 mm, trashesi ekuivalente e përgjithshme 29 mm, rezistenca termike sipas UNI EN 13163 $0.80/1.10/1.35/1.65/2.0 (\text{m}^2 \cdot \text{K}) / \text{W}$, sipërfaqe me relief te stampuar prej 27 mm per nje montim te pershtatshem dhe simetrik te tubacioneve te PE Ø17mm. Dimension 1161x663x20 mm.



Tubacioni:

Tubacion PE (polietileni) i pershtatshem per sisteme te ngrohjes se dyshemese, tip PE-Xc me densitet te larte, me barriero kunder oksidimit sipas normave Teknike EN ISO 15875 dhe DIN 4726, qe garanton nderlidhjet dhe karakteristikat. Diametri 17 mm, spesori 2 mm.





Flete perimetrale polietileni:

Flete polietileni per instalim perimetral ne cdo ambient, me funksion absorbimin e bymimit-tkurrijeve te dyshemese per shkak te nxehe-ftohjes si edhe barriere termike dhe akustike ndaj dyshemese dhe mureve perimetrale, njera faqe me ngites, tjetra me film mbrojtes mekanik. Spesori 5mm, lartesi 150 mm.



Aksesore te imet per montim:

Kapese, fasheta, brryl




Aditiv i lengshem:

Aditiv i lengshem per rritjen e percjellshmerise termike dhe vetive mekanike te shtreses. Dozimi 3lit/m3.



Kolektoret:

Kopie kolektoresh (dergim + kthim), shperndares i rrjetit hidraulik te ambienteve, i prodhuar prej bronzi ose plastik, cdo derivacion i kompletuar me valvola dhe rregullator elektrotermik, mates i prurjes se ujit, valvol per shkarkimin e ajrit, rakorderi e pershtateshme per derivacionet e tubacioneve PE me diam 17 mm, stafa fiksimi per montim ne kaseten perkatese.



Kontrolli i temperatures:

Termostat per montim ne ambjent te brendshem, perfshire dhe kontrollerin perkates i cili mund te jete i inkorporuar ne termostat ose me vete per montim brenda ne kaseten e kolektorit.

